



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 56**

Datë: 02. 08. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuviq, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPC: Ylli Buleshkaj, drejtor.

Përkthyese: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.53/2021
3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së
4. Aktivitetet e ZRPC-së:

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike 'Forca e Diasporës'

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditim të vëzhguesve

## **5. Raport nga Këshillat e KQZ-së:**

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të Fletëvotimeve për Zgjedhjet për Kuvend Komunal dhe Kryetar Komune

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për shtypjen dhe mbikëqyrjen e procesit të shtypjes së fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021.

### **Këshilli për Personel**

Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit vjetor të punës për Drejtorin Ekzekutiv të ZRPPC

dhe Zëvendës Krye shefin Ekzekutiv në SKQZ

## **6. Të ndryshme !**

---

### **Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi** : Po fillojmë me mbledhjen e 56-të të KQZ-së, të gjithë anëtarët janë prezentë, rendin e ditës e keni para vetes. A ka dikush diçka me shtuar, apo ndonjë propozim lidhur me rendin e ditës ? Kush është për këtë rend të ditës ?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë, e kemi shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nr. 53 të KQZ-së, a ka dikush ndonjë vërejtje apo, çka do... ? Urdhëro z. Kurteshi...!

**Sami Kurteshi** : Unë, e kam lexue me vëmendje këtë procesverbal, ka të bëjë edhe me një rast që është nxjerrë në media, formën qysh është nxjerrë, unë kërkoj që përgjegjësi, krye shefi që ta dorëzoj procesverbalin në prokurori për rastin...Kjo është kërkesa e parë, kërkesa e dytë është që të gjithë personat që janë në sallë, i lus edhe njëherë me e vendos maskën, po hyjnë në sallë edhe nuk po e vendosin maskën...E treta, i lus personat që e kanë inskenuar rastin në media duke gënjiye me shkue në polici dhe me dhënë deklarata për mënyrën qysh i kanë keq informuar mediat dhe, qysh i kanë instruktuar mediat dhe dëshmitarët për rastin e maskave!

Një, po e përmendi se ditën kur ka ndodh rasti kanë qenë të infektuar 2541 persona.

Dy, unë e kam bë një kërkesë të ligjshme, mos me pas njerëz pa maska në institucion, kjo është edhe në procesverbal dhe unë kërkoj që procesverbali me u dërgua në prokurori dhe përgjegjësit, me i dërguar kamerat e korridorit në prokurori për me e ditë saktësisht se çka ka ndodhë. Kjo është kërkesë e ime ligjshme...

**Kreshnik Radoniqi** : Lidhur me procesverbalin nëse nuk ka dikush diçka tjetër, a mundemi me votue ? Kush është për miratimin e procesverbalit ? Atëherë, me vota unanime miratohet procesverbal i mbledhjes së 53-të të KQZ-së.

### **3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati, është në procesin e përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve që do të mbahen me 17 tetor 2021 ,raportin e kemi me shkrim te pranuar përmes email-it, në pikë të shkurta do të mundohem disa prej aktiviteteve kryesore ti shpalos ,aktualisht jemi në periudhën e shërbimit votues për ndërrimin e qendrave të votimit, periudhë e cila ka filluar me 20 korrik dhe do të përfundoj me 7 shtator, pra pej datës 10 korrik e deri me 1 shtator pra rreth 5000 votues kanë kërkuar për ndërrimin e qendrave të votimit përmes platformës online ndërsa 600 kërkesa kanë qenë fizike për ndërrimin e qendrave të votimit të cilat janë parashtuar direkt në zyrat e komisioneve komunale zgjedhore. Gjithsej, deri tanë kemi pranuar rreth 5600 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit, po ashtu aktivitet tjetër janë edhe përgjigjet nga ankesat e bëra në PZAP dhe kryesisht shumica prej tyre janë ankesa të parashtuara nga aplikuesit jashtë Kosovës në lidhje më përfshirjen apo mos përfshirjen e tyre në lista.

Nga data 23 gusht deri më 3 shtator, tha z. Ahmetaj, Sekretariati u është përgjigjur kërkesave të apeleve të parashtuara në PZAP nga votuesit Jashtë Kosovës ,numri i përgjigjeve në kërkesa të PZAP-së në apelet e parashtuara deri me 1 Shtator është 596 përgjigje pra nga rreth 600 ankues të cilët janë ankuar PZAP deri me datën 1 Shtator ka marrë vendim për pranimin e 18 apeleve të ankuesve dhe ka detyruar KQZ-në që të përfshihen në listën e votuesve jashtë Kosovës. Po ashtu, në raport i keni edhe aktivitetet tjera një ndër aktivitetet dhe situata më të cilën jemi duke u ballafaquar me masat anticovid pra situata pandemike, pra duke u bazuar në këtë situatë dhe vendimin e qeverisë së RKS vazhdimesh iu është bërë thirrje të gjithë stafit përfshirë edhe stafin jo permanent të cilin e kemi angazhuar për këto zgjedhje që të vaksinohen, po ashtu në anën tjetër të gjithë stafit të Sekretariatit përmes drejtoreve të departamenteve janë njoftuar se me datën 13 shtator e tutje nuk mund të hyjnë në objektet e KQZ-së pa pasur një ...

Po ashtu, kemi marrë masa që i gjithë stafi që e kemi nëpër terren përkatësish në secilën komunë bëjmë thirrje të vazhdueshme që të vaksionohen ndërsa jemi duke përgatitur planin dhe i bëjmë thirrje po ashtu, subjekteve politike kur të vjen periudha e nominimit të anëtarëve të këshillave të vendvotimeve mundësish të na dërgojnë stafin apo personelin që janë të vaksinuar në mënyrë që të mos kemi pengesa ,dhe në fund fare para se me filluar procesi zgjedhor ditën e zgjedhjeve ndoshta kish qenë mire që te kemi një marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë në mënyrë që ti mundësohet të gjithë trupave zgjedhore që të bëhet vaksinimi në mënyrë që të mos kemi pengesa në ditën e zgjedhjeve pra në pikë të shkurta, këto janë aktivitetet tona...

**Alim Rama:** Deshta me u ndërlidhë me një pyetje nga mbledhja e kaluar..... (nuk dëgjohet...)

**Kreshnik Radoniqi:** Sa kam njohuri ka mbete me u bë procesverbali i Komitetit të Auditimit dhe, me u pa në procesverbal se çka është konstatuar lidhur me atë vendim por, sa i përket dërgimit të një raporti në prokurori, një kallëzim penal me parashtuar, atë mund ta bëjë çdokush ! Kallëzimin penal, mund ta bëni edhe ju, do të thotë me e dorëzuar reportin, por sa kam njohuri në Komitetin për Auditim keni marrë një vendim...

**Sami Kurteshi:** Faleminderit z. Kryesues. Ne, nuk e kemi marrë procesverbalin, kam kërkuar që procesverbalet e Komitetit të Auditimit të rregullohen, nuk e di si i ka rregulluar Sekretariati çështjen e regjistrimeve dhe mbajtjes së procesverbalit. Unë, kam kërkuar që kjo të bëhet...)

**Kreshnik Radoniqi :** Edhe diçka tjetër a pate Alim ? Si të themi, ajo nuk është çështje që bëhet vonë, ajo nuk do të mbetet e padërguar d.m.th, sa po më kujtohet, e vendosëm me pa në procesverbal çka ka qenë vendimi i Komitetit se në KQZ, ka qenë veç një njoftim i z. Kurteshi sa i përket aktiviteteve të Komitetit, asgjë tjetër dhe s'ka qenë me marrë vendim...

**Alim Rama:** Secili prej neve mundet me dërgua reportin e Auditorit në prokurori, por kryesuesi i KQZ-së e përfaqëson KQZ-në në institucionet jashtë. Në reportin e Auditorit, është rekomandimi i qartë që rekomandohet d.m.th, ajo ka qenë në reportin e auditorit edhe në njoftimin në mbledhjen e KQZ-së...

**Kreshnik Radoniqi :** Okej, e marrim procesverbalin dhe e shikojmë edhe njëherë... Z. Stollaj...?

**Fazli Stollaj :** Në lidhje me aktivitetin e angazhimit të stafit jo permanent, kisha dashtë që përveç kriterit profesional që kërcohët në konkurs, të përfshihet edhe kriteri etnik dhe gjinor në mënyrë që të kemi gjithë përfshirje në këtë staf...

**Ibrahim Selmanaj:** Për korrektësi, meqenëse jam anëtar i Komitetit të Auditimit nuk jam kundër veprimeve të cilat duhet të shkojnë në prokurori, përkundrazi secili dyshim apo keqpërdorim i mundshëm që ka mund të ndodhë duhet të ballafaqohet me të vërtetën dhe drejtësinë. Komiteti, në takimin që ka mbajtë nuk ka pas rekomandim të ndonjë materiali çfarëdo qoftë të dërgohet në prokurori d.m.th., jam anëtar i atij komiteti, dhe nuk ka pas ndonjë rekomandim...

**Florian Dushi :** A ka mundësi me na njoftua për cilin raport të auditimit, reportin vjetor apo ndonjë raport të brendshëm se me sa e di unë, në këtë drejtim Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, auditorit gjeneral kombëtar dhe prokuroria bashkëpunojnë. Këto raporte, shqyrtohen ex officio, pra prokuroria duhet ta verifikojnë nëse është kështu, do të ishte më e mirë dhe më e lehtë për mos me i mbet vlerësimi askujt, nëse diçka duhet të dërgohet në prokurori ose jo, thjeshtë le të mbetet çështje e cila neve na obligon me qenë të hapur, me qenë transparentë dhe me qenë bashkëpunues por në fakt, nuk do të merrnim individualisht iniciativa të tilla por, kjo do të zhvillohet në një koordinim ndërinstitucional. Ka pas raste të tilla kur raportet vjetore të institucioneve të ndryshme, janë shqyrtuar nga prokuroria e shtetit për të parë nëse eventualisht gjetjet apo vërejtjet e auditorit kanë edhe elemente të veprës penale...

**Sami Kurteshi:** .....(nuk dëgjohet ). Përveç këtij reporti, është edhe një report tjetër i mëhershëm dhe ne e kemi diskutuar z. Selmanaj, e kemi diskutua në Komitet të Auditimit. Aty, ne e kemi nxjerr d.m.th., unë e di personalisht: ata kanë thënë se reporti ka shkelje të mëdhaja por, natyrisht që duhet me vendosë ne, edhe ky duhet të shkojë në prokurori sepse nga Komiteti i Auditimit janë konstatua shkelje shumë të mëdha, jo të rënda por shumë të rënda prandaj, është punë e institucioneve kompetente...

**Florian Dushi:** Lidhur me reportin: nëse e shohim reportin si tërsi, ne po e vërejmë dhe krye shefi foli rreth disa masave që ai do të ndërmerre në fazën e angazhimit të stafit jo permanent, më tutje edhe të trupave zgjedhore të cilat do të themelohen në bazën e nominimeve që do të vijnë nga subjektit politike. Por, megjithatë, unë konsideroj dhe kërkoj nga Sekretariati që në ditët në vijim të hartoj një plan të detajuar të masave dhe mënyrës sesi do të funksionojmë ne si institucion duke respektuar masat e vendosura për pandeminë nga qeveria e Kosovës dhe sidomos, një plan i cili lidhet me ditën e zgjedhjeve.

**Burim Ahmetaj :** Për javën e ardhshme, do ta përgatisim një plan i cili do ta ketë parasysh sjelljen e gjithë trupave zgjedhorë në ditën e zgjedhjeve, si dhe për masat lidhur me pandeminë...

#### **4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike ‘Forca e Diasporës’**

**Ylli Buleshkaj:** Ashtu siç e keni para jush në agjendë, i kemi dy nënpika në rendin e ditës, po ashtu në fund e kisha dhënë një përbledhje për dy tema të tjera. Fillimisht, me shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimit që ne e kemi dërguar në lidhje me regjistrimin e partisë politike Lëvizja Forca e Diasporës. Kjo parti politike, ka filluar procedurat e regjistrimit dhe i ka përfunduar të gjitha brenda afatit Javën e kaluar. Ka qenë edhe në shqyrtim publik të aplikacionit të këtij subjekti politik, i cili i ka krye të gjitha obligimet ligjore, dhe ne si zyre rekomandojmë në regjistrimin e kësaj partie politike. Kjo parti politike, do të jetë partia e 49-të në Regjistrin e Partive Politike të regjistruara në Kosovë.

**Kreshnik Radoniqi :** A ka dikush diçka lidhur me këtë rekomandim ? Nëse jo, e hedh në votim: kush është për regjistrimin e partisë politike Lëvizja Forca e Diasporës ?

Miratohet me vota unanime.

### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditim të vëzhguesve**

**Ylli Buleshkaj:** Rekomandimi i dytë, është rekomandimi për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2021. Kemi pranuar aplikacionin e plotë nga media vendore “Vim info Do”. Ne, rekomandojmë akreditimin e 5 vëzhguesve të kësaj media vendore për vëzhgim të zgjedhjeve të fundit. Këta vëzhgues, do të jenë afatgjatë sepse kanë aplikuar për vëzhgim të të gjithë procesit. Sa për sqarim, është një media nga veriu dhe këta i kanë vëzhguar edhe zgjedhjet paraprake: të paktën 4-5 zgjedhjet e fundit kanë qenë të akredituar...

**Kreshnik Radoniqi :** A ka dikush diçka...?

**Florian Dushi :** Ne, po e shohim rekomandimin dhe draft vendimin tuaj. Megjithatë, sidomos tani që ne jemi më të lirë si zyrë, konsideroj se është tepër me rëndësi të kemi edhe emrat. Jo sepse ne do të refuzojmë ndonjë emër të përvetshëm ose do të thurim lavde ndonjë tjetri, por thjeshtë t'i kemi emrat sa për të qenë të informuar për kënd bëhet fjalë. Për mua kjo media, është krejtësisht e panjohur ! .

**Ylli Buleshka:** Për sqarim. Ky biznes, është i regjistruar në Kosovë si biznes që ofron shërbime mediatike, jemi siguruar që të gjitha janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës...

**Kreshnik Radoniqi :** Ndoshta edhe në vendim kishë qenë mirë me i vendosë emrat...

**Ylli Buleshkaj:** Okej, ne mundemi kur ka pak vëzhgues si këta me i vendosë edhe emrat, por pastaj, kur na vijnë nga 5000 vëzhgues të partive politike, atëherë do të jetë e vështirë të vendosen në vendim por listën e bashkëngjisim, në rregull

**Alim Rama:** Në fund të fundit, duhet me qenë një uniformitet për cilindo subjekt që synon me u akreditue për me vëzhgues në procedimin e materialit, i ka emrat... Edhe ne, po, mundemi me i pa emrat para se me vendos se, ka pas implikime në zgjedhjet e kaluara ku organizata ose shoqata e peshkatarëve ka kërkuar me u akreditue për zgjedhje! Ama në vendim, nuk ka nevojë me qenë asnjë emër.....

**Florian Dushi:** Ne, e akreditojmë subjektin në fjalë për të vëzhguar por, ne akreditojmë edhe emra të përveshëm. Këta, janë vëzhgues secili prej tyre në formën e vet. Tash në këtë rast, bëhet fjalë për një medium por megjithatë, ne i pajisim me dokument secilin veç e veç prandaj, edhe duhet me qenë të informuar dhe vendimi qoftë edhe si shtojcë duhet me pas edhe listën e emrave. Ne, duhet me ditë kënd po e certifikojmë, kush janë ata emra të përvetshëm.

Në të kaluarën, i kemi pas emrat e vëzhguesve, edhe pse me mijëra kanë qenë! Unë, konsideroj që nuk është kurrfarë problemi nëse ne i kemi emrat dhe secilit vendim, i bashkëngjitet edhe lista e emrave se kush certifikohet. Sepse, në këtë formë është e rregulluar se ne nuk e certifikojmë, nuk e akreditojmë një subjekt dhe pastaj ai të mbetet i lirë dhe të bëjë përgjedhjen e stafit të vet se kush do të jenë ata por thjeshtë, ne akreditojmë subjektin dhe emrat e përvetshëm me numër të saktë të vëzhguesve! Prandaj, konsideroj që është në përputhje edhe me kërkesat e ligjit edhe të rregullave zgjedhore...

**Ylli Buleshkaj :** Atëherë, e plotësojmë vendimin, i bëjmë pjesë të vendimit edhe lista e vëzhguesve të akredituar të subjektit politik dhe, e bashkëngjisim listën e këtyre 5 personave...

**Kreshnik Radoniqi :** Atëherë vazhdojmë me këshillat e KQZ-së .....

**Ylli Buleshkaj :** Si pikë tjetër, sa për informatë, dje kemi pranuar një vendim nga Gjykata e Apelit në lidhje me dy kandidatë të cilët jemi në shqyrtim të dokumentacionit dhe, nesër do të vijmë me rekomandim para jush për të dyja rastet...

**Kreshnik Radoniqi :** Unë, e kalova votimin e akreditimit të vëzhguesve... A doni me ndryshuar, apo...? Ok, mbetet për mbledhjen e ardhshme

**Ilir Gashi :** Mendoj që këto ankimime bëhen drejtuar në KQZ. Ka qenë njëfarë praktike në KQZ me u marrë edhe Këshilli për Çështje Ligjore, qoftë edhe KQZ-ja me i pa se cilat janë përgjigjet që i ktheni në emër të vendimeve tona PZAP-it, apo edhe ndonjë instance tjetër gjyqësore. Jemi vetëm në suaza të

informacionit... Nëse ne nuk kemi certifikuar një x subjekti politik, ai ankimon vendimin tonë, a e keni parë përgjigjen ju personalisht që i kthehet PZAP-it, besoj është e qartë...

**Kreshnik Radoniqi:** Të gjitha ankesat që janë bërë në PZAP i kam pranuar nga PZAP-ja, kërkesat për përgjigje, pastaj i kam pranuar përgjigjet tona në PZAP, dhe në fund, i kam pranuar vendimet e PZAP-it...Nëse doni edhe ju me i pranuar, ato mund t'i keni...

**Florian Dushi:** Vendimet mundemi me i pa edhe në ueb faqen e PZAP-së nuk është ndonjë problem, atë që po e kërkon kolegu E që mirë është me qenë transparentë edhe pse mund të duket distribuimi te 10 anëtarë tjerë shumë punë e madhe por megjithatë ne jemi organ kolegjal dhe nuk është faji jonë që jemi 11 anëtarë por përgjigjet shkojnë në emër të KQZ-së. Në këtë rast, këto përgjigje kanë shkuar pa i parë prandaj, kjo s'ka kuptim, përgjigjet që dërgohen prej zyrës ose kujdo tjetër në emër të KQZ-së, së paku të i kemi në email ti shohim, të dimë se cila ka qenë përgjigja jonë në kërkesën e PZAP-së, çështje transparence thjeshtë...

**Arianit Elshani:** Është shumë me vend kjo kërkesë e z. Gashi. Ka qenë një kërkesë e disa prej neve si Përbërje e KQZ-së edhe në mandatin e znj. Daka që të kemi qasje dhe informacion lidhur me shkresat zyrtare që shkojnë dhe veçmas përgjigjet në raport me PZAP-in sepse sigurisht anëtaret e KQZ-së...Dikush, mund të mendoj që një shkresë ose një përgjigje mund të jetë e qëllimshme që të jetë një rezultat tjetër pra sugestiv ,mendoj që është mirë që të informohemi në raport me ato përgjigje që i japim ,nuk po them që të kemi qasje në to dhe ti përgatisim vetë përgjigjet. Se i takon zyrës ligjore dhe drejtorit të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike që të merren me arsyetimin mirëpo, që të na mbajnë të informuar lidhur me atë se çka dhe si përgjigjemi si institucion, pra besoj që është kërkesë që vlen të mbështetet nga të gjithë anëtaret meqë ka qenë kërkesë gjatë fushatës dhe zgjedhjeve të fundit...

**Sami Kurteshi:** Unë, e përkrahë plotësisht kërkesën e z. Gashi. Kërkesa është shumë e drejtë dhe po është e vërtetë çka tha z. Elshani...Kjo, është kerkuar shprehimisht për zgjedhjet e kaluara. Nuk është mundësuar dhe ka pas zhurmë për atë çështje...Shumë e drejtë: përgjigjet që dërgohen në emër të KQZ-së dhe çdo dokument tjetër që dërgohet në emër të KQZ-së, duhet ta kemi parasysh....Ne, e kemi kerkuar këtë shprehimisht...

**Alim Rama:** Po ashtu, edhe unë e përkrah ketë kërkesën sepse, kam kerkuar disa herë që të respektohet rregullorja. Në bazë të nenit 20 - të rregullores se brendshme të punës, të gjitha parashtresat që u dërgohen institucioneve të treta, draftohen prej sekretariatit...por, minden më u trajtuar edhe në

këshillin përgjegjës... Ne, nuk jemi të informuar kur shkojnë kërkesat por është përgjegjësi e Sekretariatit që të t'i draftoj, dhe se ato gjithë qysh shkojnë në emër të KQZ-së....

**Arianit Elshani:** Kryesues, realisht është pranuar nga të gjithë. Si përbërje që kemi qenë edhe në mandatin e kaluar, jemi akorduar që të njoftohen të gjithë anëtaret në lidhje me shkresat zyrtare që behën! Mirëpo, praktikisht nuk është realizuar asnjëherë kjo kërkesë, dhe mendoj që është koha tani që këto pohime lidhur më kërkesën, të përkthehen në praktikë si veprime nga institucioni dhe, të na mbajnë të informuar lidhur më shkresat zyrtare...

**Kreshnik Radoniqi:** E qarte, për mua është çështje pa nevoje më u diskutuar se duhet me pranuar edhe anëtaret, të gjitha shkresat nga PZAP ose prej zyrës....

**YII Buleshkaj:** Është besoj, një kërkesë e drejtë... Dhe, në qoftë se vendoset ashtu, të paktën për zyrën garantoj se nuk do të dërgojmë asnjë draftë përgjigje që nuk trajtohet nga KQZ-ja...

**Kreshnik Radoniqi:** Edhe unë po mendoj se duhet më u njofuar lidhur më përgjigjet, lidhur më ankesat dhe me vendimet e marra...

## **5. Raport nga Këshillat e KQZ-së:**

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të Fletëvotimeve për Zgjedhjet për Kuvend Komunal dhe Kryetar Komune**

**Arianit Elshani:** KOZ-i, ka shqyrtuar dizajnin e fletë votimeve për zgjedhjet për kuvend komunal dhe për kryetar komune për zgjedhjet lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021. Kemi pasur edhe një rekomandim nga shoqëria civile lidhur me dizajnin e fletëvotimit, ndryshimin e dizajnit të fletë votimeve mirëpo për shkake të kohës së shkurt që kemi para vetës pra zgjedhjet janë shumë afër dhe duke e marr parasysh që gjatë viteve të fundit janë mbajtur shumë pale zgjedhje që nga viti 2017-të pra zgjedhjet nacionale, zgjedhjet lokale pastaj më 6 tetor 2019: serish zgjedhje nacionale, edhe në shkurtin e këtij viti... Mendojmë se qytetaret e kanë memorizuar ketë fletëvotim që është i kahershëm, dhe çdo ndryshime i madhe i fletë votimeve, do të krijonte huti tek qytetaret në raport me mënyrën e të votuarit.

Neve, tha z. Elshani, edhe stilistikisht na dalin shifra që në raport me fletëvotimin aktual për kuvendin aktual, është një tendencë prej 8% që fletë votimet të shpallen të pavlefshme për shkake të gabimeve, endoshta për shkake të mos qartësisë nga KQZ-ja lidhur më mënyrën e votimit...! Prandaj, kemi konsideruar që të vazhdojmë më dizajnin e njëjtë me disa ndryshime teknike të cilat, lehtësojnë ne raport me përshkrimet që janë lart ku kërkohet që për fletëvotimin për kryetare të komunës të shënjohet vetëm një kandidate dhe të theksohet ajo në tre gjuhë, dhe më pas në fletëvotimin për kuvend komunal...

Po ashtu, z. Elshani tha se një rirenditje në kolonat në tre gjuhë zyrtare, sqarohet mënyra e votimit për një subjekte politike, pra, shënhet vetëm një subjekt politik që është edhe bartësi i listës për kuvend komunal, dhe në anën e djathtë të fletëvotimit është theksuar po ashtu që të rrumbullakohet, të votohet pra vetëm për një kandidate për kuvend komunal. Ky pra është dizajni, e për veç saj, do ti shtohet se mungon këtu në ketë fletëvotim, edhe kodi i vendvotimit. Kjo, është praktik që e kemi përdorur për zgjedhjet nationale dhe këto zgjedhje ku do të vendoset kodi i vendvotimit dhe do të dimë saktë për secilin fletëvotim: në cilin vendvotim ka qenë, pra nuk mund të ndodhin raste siç, kanë ndodhur në të kaluarën kur është tentuar të manipulohet vullneti qytetare duke e zhvendosur fletëvotimet nga një vendvotim në vendvotimin tjetër!

Kjo, tash e tutje nuk do të jetë e mundur për shkak se do të identifikojmë qartë në qofte së ai fletëvotim i takon atij vendvotimi ku është dashur të jetë, pra kodi do të vendoset përmbi, e që kjo është kërkuar edhe nga Sekretariati që të dërgoj atë format në mënyre elektroteknikë që ta shohin edhe anëtaret e tjerë mirëpo, është praktik që e kemi përdorur edhe në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në anën tjetër, na ka rezultuar që të jemi edhe efeqient në raport me vulat që kemi prodhuar, e që të tregohemi edhe më efeqient për shkak se realisht, është një shumë e vogël por që do të kursehet për shkak se në te kaluarën, janë përgatitur vula të veçanta për secilin vendvotim...Kjo, ka qenë kosto shtesë dhe barrë për KQZ-në...Andaj, KOZ-i, rekomandon që të miratohet ky dizajn i fletëvotimit dhe të procedohet tutje...

**Sami Kurteshi** : Faleminderit z. Kryesues, unë u përpoqa po te fletëvotimet nuk jam ndonjë njoħes i mirë i dizajnit, kam një pyetje është vrenjtë ma shumë është pyetje se si duhet ne dy fletëvotimet, këtu thotë shënjoni vetëm një kandidate edhe në ketë tjetrën thotë shënjoni vetëm një subjekt politike. A është më e drejt më thëne unë e di d.m.th, vetëm kjo është pyetje e imja, shënjoni apo votoni, unë e di që me votuar është qitet vota kur e shënjon ti e qete votën cila është më e qartë për njerëzit tanë, pyetja është që nuk është vërejte nuk është por unë e pash edhe nuk jam shumë i sigurt...

**Arianit Elshani:** Është shumë pyetje me vend z. Kurteshi... Ne, po thuaj se çdo dite po kemi ketë diskutim në Këshillin për informim publik ne raport me gjuhën që përdorim ne dokumentet dhe njoftimet e KQZ-së, ne raport me publikun se ndonjëherë ato komunikata ato video spote ato imazhe qe prodhohen nga KQZ-ja ma shumë janë raport komunikim me institucionin pra, sesa ne raport me qytetarin dhe sigurisht që edhe kjo mund të jetë një çështje që realisht definohet këtu pra nga përbërja e KQZ-së, nga anëtaret e KQZ-së në qoftë se mendojnë se vota mund të jetë më e kapshme, më e logjikshme dhe më e kuptueshme për qytetaret...

**Ilir Gashi:** Përtej këtij dizajni të fletëvotimit, e kisha ngritë edhe një çështje tjetër që ndoshta vjen pak më vone por kur e pashto fletëvotimin mu kujtuan efektet në zgjedhjet të vitit 2019 tek fletëvotimet e pavlefshme...! Mendoj se doracaku, kësaj radhe, nuk e di nëse është ndërhyrë në zgjedhjet e 14 shkurtit por, duhet me rishikuar në mënyre që mos të prodrojmë me vetëdije fletëvotime të pavlefshme...I dimë edhe përplasjet në QNR, prandaj mundemi me i trajtuar edhe në doracak në mënyre që të edukojmë me kohe edhe pjesëmarrësit, qoftë në vendvotim apo qoftë pastaj në ndonjë rinumërim të mundshëm që do të jete edhe i pashmangshëm në QNR-ë për faktin se, fillon me u kuptuar sakte dhe drejtë, pa hamendje ku një fletëvotim është i vlefshëm dhe ku i pavlefshëm, kur është bere më qellim prishja e fletëvotimit etj.

**Florian Dushi:** Po ndërlidhem më ketë të cilën kolegu Gashi: unë mendoj se përtej tendencave që mund të kenë anëtaret e këshillave të vendvitimeve që të shpallin fletëvotimet e një subjekti politik ose të një kandidati të pavlefshme, megjithatë më tepër është e rëndësishme që ne të shohim që pjesën e informimit publik të punojë me votuesit të cilët po kanë probleme me mënyrën e votimit dhe, të i informojmë për mënyrën e saktë të votimit..., ndoshta edhe duke e dyfishuar ose trefishuar materialin e informimit publik që do të ndikonte edukimin e votuesve...Sa i përket mënyrës së votimit, sepse në doracak ju bëhet tejet e qartë, edhe në trajnime e kanë tejet të qartë ngase, shumica e tyre janë njerëz që marrin pjesë ose kanë marr pjese më shumë se një pale zgjedhje, ne besoj që nuk mundemi me mohuar një tendencë që në raste të caktuara t'i shpallojnë një kandidati ose një subjekti politik eventualisht ndonjë vote e pavlefshme...

Kjo tendencë, ekziston por ata duhet me bartë përgjegjësi nëpër ketë prandaj, unë po mendoj se ne duhet të fokusohemi tek informimi i votuesit për mënyrën e votimit...Kjo është me rendësi! Sa i përketë këtyre fletëvitimeve, ne kemi parë edhe versionin tjetër që është ofruar...Personalisht nuk kam parë asnjë ndryshim përmbytjesorë me fletëvotimet të cilat, ne e kemi shfrytëzuar...Ka pasur disa ngjyra, ndonjë hijezim, disa thyerje të këtyre kornizave për me u duk më bukur dhe vërtet janë duk më bukur por, në

pjesën e aspektit përmrbajtjesor nuk ka pasur asnjë ndryshim ...Të vetmin ndryshim që kemi bere ne, është se teksti është më i ndarë sa i për ketë asaj që duhet të votohet një kandidat ose një subjekt politik...

**Sami Kurteshi:** Më gjithë atë u ngritën çështje të drejta, z. Dushi të edukimi i votuesit kjo është shumë e drejtë, edhe te mundësia e komplikimeve është e vërtet që ka pasur në QNR-ë nga provoja e mëhershme...Ka raste që nuk janë shumë të shpeshta ku ka dilema rrëth një vote, dhe me gjasë nuk ka pasur dallime të mëdhaja mes subjekteve por, dallimet më të mëdhaja kanë qenë në mes të njerëzve që është dashur të vendosin...Ajo që ka qenë më problematike, është se vendimet kanë qenë të decentralizuara dhe ka pasur mundësi që i njëjti fletëvotim që ndokund është shpallur i pavlefshëm, i njëjti është shpallur i vlefshëm...

Mendoj se, ajo se çfarë kemi kërkuar vitin e kaluar, në të vërtet në muajin shkurt, në qendër të votimit do të duhej të jetë një komision i KQZ-së ad - hok, në krye të të cilit, do të duhej të ishte njeriu kryesor i Sekretariatit i cili të merret me trajnimet sepse, ai/ajo ju thotë se çfarë është e vlefshme apo çfarë s'është e vlefshme...!

Ne, nuk themi pra ai/ajo cakton njerëzit, i trajnon njerëzit prej 3 vetash, por ajo të jetë në krye të komisionit dhe të vendos në fund se ky fletëvotim është i vlefshëm dhe ky fletëvotim është i pavlefshëm... Dhe, ai të jete vendim i KQZ-së sepse, nëse lihet në 50-të tavolina dhe trajner te ndryshëm shkojnë dhe ju thonë që unë kam 10 vite, jo unë 12 apo 8 vite, kriteret nuk janë të njëjta prandaj, ne e kemi një njeri që i trajnon të gjithë trajnerët, që e merr përgjegjësin për caktimin e asaj se çka është e vlefshme dhe se çka nuk është e vlefshme...

Edhe një herë, i lus të gjithë personat të cilët janë në sallë me e vendos maskën...!

Në këtë pikë, diskutuan sërisht, Alim Rama, Ilir Gashi, Florian Dushi, Rifat Krasniqi dhe Arianit Elshani.

**Kreshnik Radoniqi:** Faleminderit atëherë pra të gjithë po pajtohem që në vend të fjalës “shënjoni” me e vendos fjalën “votoni” e cila, do të përkthehet edhe në gjuhën serbe edhe në gjuhën turke. Apo pajtohem i të gjithë më ketë, atëherë pra e hedh ne votim?

Atëherë kush është për me ndryshim të fjalës shënoni të shkruhet votoni që është propozuar nga z. Kurteshi. Miratohet... Pra, miratohet dizajni i fletëvotimeve për zgjedhjet për kuvend komunal dhe për kryetare komune të 17 tetorit 2021, me ndryshim që fjala “shënjoni” të ndryshohet më fjalën “votoni” dhe të përcillet edhe në gjuhen serbe edhe në gjuhen turke.

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për shtypjen dhe mbikëqyrjen e procesit të shtypjes së Fletëvotimeve dhe të Broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021.**

**Arianit Elshani:** E para, sekretariati ka qene në dileme së a është çështje që duhet të trajtohen në KOZ-ë apo në këshillin për marrëdhëniet me jashtë mirëpo, pasi është trajtuar çështja si e fletëvotimeve dhe dizajni i fletëvotimeve në KOZ-ë, ne e kemi shfrytëzuar rastin që të trajtojmë ketë çështje, pra, miratimin e planit për shtypjen dhe mbikëqyrjen e procesit të shtypjes së fletëvotimeve dhe të broshurave për zgjedhjet lokale 2021. E keni të bashkangjitur secili para vetes, besoj si dokument, planin për shtypjen dhe mbikëqyrjen e procesit të fletëvotimeve dhe të broshurave ku planifikohet që mbikëqyrësi i kontratës, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi, të udhëzohen për ta parë nga afër procesin e shtypjes së fletëvotimeve duke e ditur faktin se në të kaluarën, mund të ketë raste ku mund të behet ndonjë lëshim, ndonjë gabim...Rekomandohet që dy nga sekretariatit të marrin pjesë në mbikëqyrje të procesit te shtypjes të Fletëvotimeve dhe po ashtu, nga KOZ-ja janë rekomanduar 3 pjesëmarrës për shkak edhe të obligimit ligjor që kemi të nenit 87.7 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme ku fletëvotimet shtypen dhe mbikëqyren drejtpërdrejt nga KQZ-ja...Kjo, është praktikë që është përdorur përherë nga KQZ-ë që anëtarët e KQZ-së ta shohin nga afër këtë proces të shtypjes për shkak të rëndësisë që ka...

Është rekomanduar që nën mbikëqyrje të marrin pjesë z. Rama, z, Dushi dhe z. Rifat Krasniqi, pra këta janë tre propozime nga anëtarët e KQZ-së...Në qoftë se e konsideroni si përbërje që do të duhej të merrte pjesë edhe dikush tjetër në ketë mbikëqyrje në Slloveni, atëherë jeni të lire të jepini rekomandim, dhe qëndrimet e juaja lidhur me përbërjen si KOZ-së..

**Florian Dushi:** Kjo, është një çështje që përsëritet në se cilat zgjedhje! Natyrisht, edhe buxheti dhe gjithçka tjetër është e paraparë dhe, do ta kemi edhe raundin e dytë, dhe po ashtu duhet me u zhvillua pothuajse l njëjtë proces... Por, megjithatë, mbasi që ju si "Kryetar" keni ardhur në institucionin tonë, konsideroj që duhet ta shihni këtë proces...

**Arianit Elshani:** Megjithatë, për shkak se është proces zgjedhor, i pari që sfidoheni nga ky pozicion, unë mendoj që është mirë të merrni pjesë, mirëpo në anë tjetër, edhe keni përgjegjësi të jeni këtu, duhet të kujdesemi që ta ruajmë edhe korumin brenda të KQZ-së për shkak të vendimeve që mund t'i kemi apo, rrethanave që mund të krijohen...

**Kreshnik Radoniqi:** Sidoqoftë, a ka dikush tjetër...? A është ky propozim: Floriani, Alimi edhe Rifati...? Plus unë...!

Kush është për...?

**Florian Dushi:** Le të jeni edhe ju, por vlerësojeni ju... Të njëtin mendim, e përkrahu edhe Ilir Gashi dhe Čemailj Kurtiši. Me 6 vota për, miratohet propozimi që në Slloveni të udhëtojnë katër anëtarë të KQZ-së. Kurse, i mbetet Sekretariatit që t'i caktoj dy anëtarë...

Me vota unanime, miratohet Plani për shtypjen dhe mbikëqyrjen e procesit të shtypjes së Fletëvotimeve dhe të Broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021.

### **Këshilli për Personel**

Shqyrtimi dhe miratimi i Vlerësimit vjetor të punës për Drejtorin Ekzekutiv të ZRPPC dhe, Zëvendës Krye shefin Ekzekutiv në SKQZ.

### **Të ndryshme !**